

V E N D I M

(PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK)

Ne Tirane, sot me date 6.6.1994, une Anila Capo ... Gjyqtare e Gjykatës së Rrethit, pr
si shqyrtova kërkesën e ortakëve : 1) Ndermarrja e Grumbullim Përpunim Duhan-Bime Korc
2) Greek Albanian Leaf Tobacco Company S.A. dhe 3) Leaf Tobacco Michailidhis S.A. për
tu rregjistruar si person juridik, Shoqëri Anonime,

K O N S T A T O V A S E :

Kërkesa e kërkuësve për rregjistrimin si person juridik të Shoqërisë Anonime "MIKA-
KORCA -Sh.A." me ortakë : 1) Ndermarrja e Grumbullim Përpunim Duhan-Bime Korcë, 2) Le-
af Tobacco Michailidhis S.A. dhe 3) Greek Albanian Leaf Tobacco Company S.A., me sili
ne qytetin e Korcës, me kohëzgjatje për 30 (tridhjetë) vjet, me kapital themelues
1.357.012 USD (një milion treqintepesëdhjetëshejtë e dymbëdhjetë USD) Dollare Amerike
me President Zotin Aleksandros J. Mihailidhis, me objekt veprimtarie : Shfrytëzimin dhe
rinovimin e kapaciteteve ekzistueses të Fabrikës së Duhaneve Korcë, magazinave dhe mje-
disave të tjera, të cilat janë në pronësi të kësaj fabrike, ndërtimin e kapaciteteve
të reja depozitueses e përpunueses të duhaneve në përputhje me teknologjinë bashkëkoh-
re, zbatimin e teknologjive të reja bashkëkohore për përpunimin dhe fermentimin e du-
hanit, dhanjen e ndihmes prodhuesve private nëpërmjet teknologjisë së lartë të kultivimit
të duhanit me qëllim që ata të rrisin cilësinë dhe sasinë e tij, si dhe çdo ek-
tivitet tjetër që lidhet me këtë objekt dhe që lejohet me ligj, është në përputhje me
kërkesat e ligjit Nr.7638 date 19.II.1992 "për Shoqëritë Tregtare", §68

Për këto arsye, në bazë të Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Për Rregjistrimin, regjter

V E N D O S A

Tu rregjistroj si person juridik Shoqërisë Anonime "MIKA-KORCA-Sh.A." me ortakë :
1) Ndermarrja e Grumbullim Përpunim Duhan-Bime Korcë, 2) Greek Albanian Leaf Tobacco

Faqe e dyte e Vendimit

Company S.A. dhe 3) Leaf Tobacco Mihalidhis S.A., me objekt veprimtarie : Shfrytëzimin dhe rindërtimin e kapaciteteve ekzistuese të Fabrikës së Duhanave Korçë, magazinëve dhe mjediseve të tjera, të cilat janë në proces të kësaj fabrike, ndërtimin e kapaciteteve të reja deponimesh e përpunimesh të duhanave në përputhje me teknologjinë bashkëkohore, zbatimin e teknologjive të reja bashkëkohore për përpunimin dhe fermentimin e duhanit, dhanjen e ndihmës prodhuese private nëpërmjet teknologjisë së lartë të kultivimit të duhanit me qëllim që ata të rrisin cilësinë dhe sasinë e tij, si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me këtë objekt dhe që lejohet me ligj.

Kunder këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

G J Y K A T A R E

/ Anila Cepo /



KONTRATE THEMELIMI

E SHOQERISE ANONIME " MIKA-KORÇA " SH.A.

4781

Personat e poshtëshenuar, qe kane firmosur kete kontrate :

1. NDERMARJAE GRUMBULLIM PËRPUNIM DUHAN-BIMË Korçe, person juridik regjistruar dhe me seli në Korçë, qe vepron ne baze te legjislacionit shqiptar, perfaqesuar nga Drejtoresha e saj zonja Jeta Thellimi, shtetase shqiptare, me banim në Korçë .

2. GREEK-ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY S.A., person juridik regjistruan ne Selanik te Greqisë, qe vepron ne baze te legjislacionit grek, perfaqesuar nga z. Aristidhis Lekkas, shtetas grek, me banim ne Selanik.

3. LEAF TOBACCO-MICHAILIDHIS S.A., person juridik i regjistruar në Selanik te greqisë, qe vepron ne baze te legjislacionit grek, perfaqesuar nga z. Aleksandes Michailidhis, president i shoqerisë, shtetas grek, me banim ne Selanik.

Kane rënë dakort sa më poshte vijon :

Te themelojne nje shoqeri anonime pa afertë publike te emertuar "MIKA-KORÇA" SH.A. me objekt shfrytëzimin dhe rinovimin e kapaciteteve ekzistuese te fabrikes, magazinave dhe mjediseve te tjera te cilat jane ne pronesi te Ndermarjes Grumbullim Përpunim Duhan-Bimë, ndertimin e kapaciteteve te reja depozituese e përpunuese te duhanit ne perputhje me teknologjine bashkëkohore , zbatimin e teknologjive te reja bashkëkohore për përpunimin dhe fermentimin e duhanit, dhenijen e ndihmes prodhuese private nepermjet teknologjise te larte te kultivimit te duhanit me qellim qe ata te rrisin cilesine dhe sasine e tij si dhe çdo aktivitet tjeter qe lidhet me kete objekt dhe qe lejohet me ligj.

Kapitali themeltar i kesaj shoqërije eshte 1.357.012 USD (Njemilion e treqind e pesedhjetë e shtate mije e dymbëdhjetë USD) i ndarë ne 13.570 aksione nominative, me vlere 100 dollare USA secili.



Te 13.570 aksionet janë aksione të nenashkruara për kontribute në natyrë të aksionerëve.

Vlera e objekteve, makinerive dhe paisjeve që përbejnë kapital themelor të shoqërisë, pasqyrohen në listat që i bashkelidhen kësaj kontrate, në të cilat kontributi i palës shqiptare është sipas listës Nr.1, kurse ai i palës greke sipas listës Nr.2.

Në bazë të këtyre përpjestimeve në kontributin në kapital do të përcaktohen në ~~88~~ ardhjen edhe problemet e tjera ekonomike financiare të shoqërisë. Përveç sa më sipër, pala Greke merr përsipër investimet sipas listës Nr.3, vlera e të cilave do të shlyhet nëpërmjet kostos së produktit të gatshëm.

Instalimi i makinerive dhe paisjeve do të perfundojë brenda 12 muajve nga dita e marrjes së autorizimit nga qeveria shqiptare dhe do të kryhet nën përgjegjësinë e palës greke.


Firmuesit e kësaj kontrate deklarojnë se, pasi kanë marrë dijeni për listën e aksionerëve të ardhshëm dhe kanë marrë një kopje të legalizuar të kësaj liste, shumat e shlyera prej tyre janë në përputhje me këtë listë dhe konfirmojnë nënshkrimin e tyre për kontributin në natyrë si më poshtë :

1. NDERMARJA E GRUMBULLIM PËRPUNIM DUHAN-BIMË 4850 aksione.
2. GREEK-ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY S.A. 1120 aksione.
3. LEAF TOBACCO -A. MICHAÏLIDHIS S.A. 7500 aksione.

Pas miratimit të këtyre deklaratave, nënshkruesit e aksioneve për kontributin në natyrë, rane dakort të adoptojnë statutin bashkëngjitur.

Bërë në Korçë, në gjuhët shqipe dhe anglisht, duke patur të dy tekstet fuqi të barabartë.

1. NDERMARJA E GRUMBULLIM PËRPUNIM DUHAN-BIMË
2. GREEK-ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY S.A.
3. LEAF TOBACCO A. MICHAÏLIDHIS S.A.


Alex J. Michael

S T A T U T

I SHOQERISE ANONIME " MIKA-KORÇA " SH.A.

Neni 1

Shoqeria ne forme anonime zhvillon veprimtarine ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e ketij statuti.

Neni 2

Emertimi i Shoqerise

Shoqeria emertohet " MIKA-KORÇA " SH.A. me poshte e quajtur "shoqeri".

Neni 3

Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka per objekt te kryeje veprimtari te ligjeshme ne fushen e shfrytesimit dhe rinovimit te kapaciteteve ekzistuese te f fabrikes, magazinave dhe mjediseve te tjera, te cilat jane ne pronesi te Ndermarrjes Grumbullim Perpunim Duhan-Bime, ndertimin e kapaciteteve te reja depozituese e perpunuese te duhaneve ne perputhje me teknologjine bashkohore, zbatimin e teknologjive te reja bashkohore per perpunimin dhe fermentimin e duhanit, dhenien e ndihmes prodhuese private dhe shteterore nepernjat teknologjise se larte te kultivimit te duhanit me qellim qe ata te rrisin cilesine dhe sasine e tãj si dhe çdo aktivitet tjeter qe lidhet me kete objekt dhe qe lejohet me ligj, dhe qe konsiderohet si i nevojshem ose fitimprures nga shoqeria.

Neni 4


Selia e Shoqerise

Shoqeria e ka seline e saj ne Korçë

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqerise

Me perjashtim te rastit kur shoqeria priset para kohe



ose kur mbledhja e jashtezakoneshme epergjitheshme e Asamblese se Aksionereve vendos per zgjatje afati,kohezgjatja e shoqerise përcaktohe për 30 vjet,duke filluar nga dita e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar.

Neni 6

Kapitali dhe kontributet

A) Kontributet

Kontributet ne kapitalin themeltar te shoqerise janë ne natyre si me poshte ;

1. NDERMARJA E GRUMBULLIM PËRPUNIM DUHAN-BIMË kontribon në shoqëri me 485.012 USD qe u pergjigjen 4850 aksioneve me vlerë 100 USD secili.

2.GREEK-ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY S.A. kontribon ne shoqëri me 122.000USD qe i pergjigjen 1220 aksioneve me nje vlerë 100 USD secil

3. LEAF TOBACCO -A.MICHAALIDHIS S.A.,kontribon ne shoqëri me 750.000 USD qe i pergjigjen 7500 aksioneve me nje vlere prej 100 USD secili.

B) Kapitali :

Kapitali themeltar eshte 1.357.012 USD,i ndare në 13.570 aksione nominative me nje vlere 100 USD ,te te njejtes klase dhe me numër serie nga 1 deri në 13.570.

- 4850 aksione,me numer serie prej 1 deri 4850 i jepen Ndermarjei se Grumbullim Përpunim Duhan-BIMË.

- 1220 aksione,me numer serie prej 4851 deri 6070 i jepen Greek-Albanian Leaf Tobacco Company S.A .

- 7500 aksione , me numur serie prej 6071 deri në 13.570 i

jepen Leaf Tobacco-Michailidhis.

Neni 7

Forma e aksioneve

Aksionet jane plotsisht te shlyeshme dhe te formes nominative. Shlyerja e aksioneve behet ne nje banke shqiptare.

Nensjkrimet e aksioneve dhe shumat e derdhura evidentohen nga nje certifikate e dhene nga banka e lartpermendur.

Ne rast humbjeje te certifikates nominative, aksioneri duhet te njoftoje shoqerine dhe te publikoje nje deklarate per humbjen ne nje gazete zyrtare. Per nje periudhe prej nje viti nga ky publikim, aksioneri nuk mund te kerkoje pagimin e asnje dividenti. Pas kesaj kohe dhe ne rast se certifikata nuk eshte gjendur, atij i leshehet nje dublikate e certifikates se humbur. Shpenzimet e kesaj procedure i ngarkohen aksionerit ne fjale

Neni 8

Te drejtat qe rjedhin nga zoterimi i aksioneve

Qdo aksioner ka te drejte vote proporcionale me numurin e aksioneve qe ai zoteron. Qdo aksioner jep te drejten e nje vote. Per te patur te drejten e pjesmarrjes ne mbledhjet e asamblese qdo aksioner duhet te zoteroje 10 aksione. Disa aksionere mund te bashkohen per te arritur kete minimum dhe ~~mund~~ te perfaqesohen nga njeri prej tyre.

Neni 9

Shlyerja e aksioneve

Keshilli mbikqyres, ose drejtoria, sipas vendimit te Asamblese se Pergjitheshme, fikson kushtet qe lidhen me vleren e aksioneve te emtuara qe ne themelimin e shoqerise ose gjate zmadhimit te kapitalit themeltar, te cilat do te shlyhen me para ne dore;

Lajmerimet per shlyerjen e aksioneve u behen te ditur nenshkruesve ose aksionereve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per çdo shlyerje, nepermjet nje njoftimi te publikuar ne nje gazete zyrtare ose me ane te letrave individuale rekomande.

Ne mungese te shlyerjes nga aksioneri, te shumave sipas vleres se aksioneve te nenshkruara prej tij, brenda te afatit te fiksim nga organet e permendura ne paragrafin e pare te ketij neni, drejtoria i drejton atij nje paralajmerim. Neqoftese te pakten/1 muaji ky paralajmerim mbetet pa efekt, shoqeria ben shitjen e ketyre aksioneve pa asnje autorizim gjygsor.

Shoqeria kate drejte te emetoje aksione nominative, aksioner per pruresin si dhe aksione me perparesi.

Neni 10

Asamblea e aksionereve

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga keshilli mbikqyres, drejtoria, ekspertet kontabel si dhe nga nje grup aksioneresh qe zoterojne te pakten 1/10 e aksioneve ose nga likuiduesit.

Aksioneret marrin pjese ne mbledhjet dhe shqyrtimet e asamblese dhe kane te drejte vote proporcionale me numurin e aksioneve qe zoterojne. Ne mbledhjet e asamblese duhet te marrin pjese ose te jene te perfaqesuar mbi 1/2 e aksionereve.

Asamblea e aksionereve vendos per llogarite vjetore, per ndryshimet ne statut, per zvogelimin ose zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise, per marrimin ose shkarkimin e anetarave te keshillit mbikqyres e te eksperteve kontabel, per pushtimin e veprimtarise se shoqerise per likuidimin ose riorganizimin e saj.

Asamblea merr vendim me nje shumice votash prej 3/4 qe ju perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar per qeshtje te



tilla si ndryshimet e dispozitave te statutit, zvogelimi i kapitalit th
mehtar, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo pushimi i vepr
mtarise se saj me ane te likuidimit.

Asamblea merr vendim me nje shumice votash prej 1/2 qe
ju perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar per qeshtje te
tilla si miratimi i llogarive vjetore dhe ndarja e fitimeve, emerimi
ose shkarkimi i anetrave te keshillit mbikqyres, eksperteve kontabel dh
likujdvesve si dhe per qeshtje te tjera.

Asamblea mblidhet te pakten nje here ne vit.

Neni 11

Keshilli mbikqyres

Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem mbi
drejtorine lidhur me administrimin e shoqerise prej saj.

Vrejtjet mbi raportet e drejtorise dhe mbi llogarite e
vitit financiar ai ja paraqet per shqyrtim asamblese. Ne qdo kohe
keshilli mbikqyres kryen verifikimet dhe kontrollet qe ai i gjykon te
arsyeshme dhe mund te kerkoje te njahet me te gjitha dokumentet e nevo
jeshme per plotsimin e detres se tij.

Keshilli mbikqyres perbehet nga tre anetare te cilet nuk
duhet te jene anetare te drejtorise. 2/3 e anetareve te keshillit mbi-
kqyres emerohen nga asamblea me nje mandat 3 vjeqar i cili mund te
perseritet, ndersa 1/3 e anetareve te tij zgjidhet nga te punesuarit e
shoqerise me nje mandat 2 vjeqar te perseritshem.

Ne keshillin mbikqyres mund te merehet edhe nje person
juridik, i cili perfaqesohet nepermjet nje perfaqesuesi te perhershem.

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij
presidentin dhe zevendespresidentin, qe ngarkohen me mbledhjen e keshill
it dhe drejtimin e debatit.

Presidenti dhe zevendespresidenti i keshillit mbikqyres

jane persona fizike dhe mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te personave juridike. Ata ushtrojnë funksionet e tyre gjate tërës periudhes se mandatit te keshillit mbikqyres.

Ne mbledhjet e keshillit mbikqyres duhet te marrin pjese mbi 1/2 e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice votash të mbi 1/2 te anetareve te pranishem ose te perfaqesuar. Ne rast rezultati te barabarte votash, vota e presidentit eshte vendimtare.

anetaret e keshillit mbikqyres mund te marrin pjese, me votë konsultative, ne te gjitha mbledhjet e asamblese se aksionereve. Ata kane vote vendimore ne asamble vetem kur e zoterojne ate me cilesine e aksionerit.

Neni 12

Drejtoria

Drejtoria perbehet nga drejtori dhe zevendes drejtori. Ata emerohen dhe shkarkohen nga keshilli mbikqyres. Ata duhet te jene persona fizike dhe mund te zgjidhen jashte bashkesise se aksionerëve.

Drejtori dhe zevendes drejtori zgjidhen per nje mandat 3 vjeçar i cili mund te perseritet.

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne çdo rrethane ne emer te shoqerise brenda objektit te saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ja njeh shprehimisht keshillit mbikqyres dhe asamblese se aksionereve.

Aktet e drejtorise, dhe kur dalin jashte objektit te veprimtarise se shoqerise, jane te detyrueshme per shoqerine ndaj te tretëve, me perjashtim te rastit kur te tretet kane qene ose duhej te ishin ne dijeni qe keto akte te jkallonin objektin e veprimtarise së shoqerise.



Te pakten nje here ne tre muaj drejtorial paraqet raportin keshillit mbikqyres, ndersa pas mbylljes se vitit financiar ajo i paraqet nje raport, ku pasqyrohet gjendja e shoqerise, asamblese se aksionereve.

Anetaret e drejtorise mund te marrin pjese me vote konsultative ne te gjitha mbledhjet e asamblese. Ata kane vote vendimore ne asamble vetem kur e zoterojue ate me cilesine e aksionerit.

Neni 13

Ekspertet kontabel te autorizuar

Asamblea emerohet nje ose me shume eksperte kontabel te autorizuar, te cilet ushtrojne misionin kontrollues mbi veprimtarine financiare te shoqerise ne perputhje me ligjin.

Ata emerohen per nje mandat tre vjeshar i cili mund te perseritet.

Sistemi i kontabilitetit i perdorur nga shoqeria do te jete ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

Ne drejtori mund te punesohet edhe nje anetar tjeter si keshilltar financiar dhe ekonomik, i cili mund te jete ose jo aksioner.

Neni 14

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe asaj kolektive.

Per qeshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes ose te asaj kolektive zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar te pune

Neni 15

Prishja dhe likuidimi i shoqerise.

Prishja e shoqerise eshte ne kmpetence te asamblese se aksionereve.

Me perfundimin e afatit sipas statutit, shoqeria prishet automatikisht. Ne kete rast asamblea merr vendim per likuidimin ose

për riorganizimin e shoqërisë.

Ne rast se si rezultat i humbjeve të konstatuara në dokumentet kontabël, kapitali i veta të shoqërisë behen me të vogla se gjysma e kapitalit themeltar, drejtorja detyrohet brenda 4 muajve nga miratimi i bilancit financiar kur është zbuluar kjo humbje, të thërrasë asamblenë me qëllim që të merret vendim nëse ka vend për prishjen e shoqërisë.

Kur shoqëria likuqdohet :

- Asamblea me propozimin e keshillit mbikqyres, emeron likuiduesit të cilët i paraqesin asaj raportin e likuidimit dhe shoqëria e jep fund veprimtarisë së saj pas miratimit të këtij raport.
- pasuritë dhe koncesionet që i janë vënë në dispozicion shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, i kthehen pronarit të mëparshëm;
- fondet që rezultojnë pasi të jenë paguar të gjithë kreditorët, ju ndahen aksionarëve në proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 16

Cdo mosmarrëveshje, dyshim ose konflikt, do të zgjidhet në Arbitrazhin e Dhomës Nderkombetare të Tregëtisë së Parisit në përputhje me legjislacionin Zviceran.

Neni 17

Dispozita të fundit.

Ky statut u hartua në dy ekzemplarë origjinale, me datë 25.3.1993 në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, duke patur të dy tekstet fuqi të barabartë.

NDERMARJA E GRUMBULLIM PËR PUNIM DUHAN-BËMË

GREEK-ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY S.A.

LEAF TOBACCO- A. MICHAELIDHIS S.A.

